

Statuti i Partisë Balliste

Qëllimi i konstituimit të Partisë Balliste

Partia Balliste ka vepruar dhe vepronë më normat e frymës kombëtare, për të mirën e Trollsit dhe Popullit të vet, është parti suverene që nuk i nënshtrohet autoritetit të asnjë instance politike, filozofike, religjioze dhe as sociale. Për t'ia arritur qëllimit dhe pikësynimit të vetë, mundë të bëhet anëtare e asociacioneve nacionale dhe internacionale, pa e kufizuar autonominë e vetë politike e as suverenitetin atdhetar.

Statutet dhe Programi i P.B-esë janë në harmoni të plotë më interesat e popullit Kosovar dhe ka pikësynim politik të një pushteti popullor.

Partia Balliste është subjekt politik, që në praktikë ka idetë e ballizmit dhe bazohet në principet e vlerave morale, gjegjësishtë në solidaritet dhe egalitet të shancave të të gjithë bashkatdhetarëve: rrespektonë të drejtat e njeriut, të lirive fundamentale, si dhe Konventat relative për të drejtat e fëmisë. – P.B-ja rrespektonë çdo fe e besim fetar dhe ka kujdes të veçantë ndaj atyre që plotësojnë apo mundohen t'i plotësojnë normat njerëzore.

Partia Balliste ka objektiv : Të ushtrojë pushtet apo së paku të marrë pjesë në pushtet, që për P.B-në pilyalizmi dhe vendosëja në konkurrencë të formacioneve të ndryshme politike janë një temel i guvernimit popullor dhe lirisë së opinjonit, gjithashtu të rrespektohet liria e adherimit të personëve në këtë apo në tjetër parti.

P.B-ja rrespekton konkurrentët dhe konkurrencën.

Partia Balliste participon në animacion të jetës politike dhe e konsideronë veten ndërmjetësuese në mes të popullit dhe pushtetit: i recensonë kërkesat apo nevojat e popullit dhe i transformonë në program partie.

P.B-eja, më të tanishmin konstitution, konservonë të drejten e vet, mbrenda dhe jashtë shtetit tonë:

- të veprimtarive politike, botuese, organizimit e menaxhimit të programeve t'aktiviteteve dhe klubeve kulturore, sportive, politike - të organizuera apo të instoruara, çdoherë të planifikuera nga Partia Balliste, e n'asnjë mënyrë ndër imponimin e përsoneit të dytë.
- P.B-eja konservonë të drejten e vet, mbrenda dhe jashtë shtetit tonë, të përkrahjes, lidhëshmerisë e bashkëpunim-aktivitetesh më parti e qendra vendore dhe të hueja adhuruese dhe përkrahëse të idéaleve dhe kulturës së ballizmit;
- P.B-ja gjithashtu ka parasyshtë konstituimin e degëve të nevojshme për interesat e partisë;
- P.B-eja parashef krijimin e institucionit brenda partisë për pranimin e fondeve, donacioneve, subvencioneve politike dhe ndihmave financiare për zhvillimin e

- aktiviteteve me qëllim të mbajtjes së egzistencës së Partisë, ashtu si i takon dhe që e kërkon nevoja dhe interesi absolut i Partisë Balliste dhe
- të gëzonë të drejtën e shfrytëzimit, posedimit dhe të drejtën autoritare në të lartëcurat e të funksionojë lirshëm dhe e pavarur.

Pajazit Podrimçaku,
Lider dhe Kryetar i Përgjithshëm i Partisë Balliste

KREU I I-RË

Neni 1

Konstituimi i Partisë Balliste me Statut dhe Program partie

Viti 2018, dita e 2-të e muajit Prill, në Novosellë (Fierzë) – Rrethi administrativ Pejë, që nënshkruesit e Kuvendit themelues të Partisë Balliste janë marrë vesh në mes veti dhe më ata që dëshiruan të adherojnë në statutet e të tanishmit akt, për të formuar një shoqatë pa qëllim fitimi, në nivel e kualitet të partisë politike, dhe të veprojnë konform ligjeve për subjektet politike, sipas strategjisë së ballizimit, duke u bazuar në statutet e të tanishmit akt të partisë, ashtu siç e kërkon interesi atdhetar dhe kombëtar.

Me vendim të Kuvendit themelues u formua subjekti politik, i cili u emërua „Partia Balliste“.

Neni 2

Partia Balliste u kompletua më Statut dhe Program të vet

Partia Balliste në strukturën e saj përmban titujt dhe pjesët zyrtare që një parti duhet t'i ketë :

- Statutin,
- Programin,
- Emrin dhe siglën
- Logon,
- Flamurin zyrtar,
- Flamurin ceremonial,
- Vulën dhe
- Selinë

Emri dhe sigla e Partisë

Partia mbanë emrin „**Partia Balliste**“ dhe siglën apo akronimin „**P.B**“ .

Logo

- Logo e Partisë ka formën katrore me dimensione bazë : 35cm x 35 cm,
- Ortoqendra e katrorit ka formën rrethore më ngjyrë të kuqe e shqiponjë të zezë bicefale në qendër, atë të Partisë Balliste, e rrethuar më tri unaza: të zezë, të kuqe dhe një unazë kurorë-ngjyrë-ari.
- Në unazë të zezë figuronë emri i Partisë. Emëri është i shkruar më shkronja të kuqe, ndërsa akronimi “P.B” figuronë më shkronja të zeza në një elipsë të kuqe në unazë të zezë mbi dy krerët e shqiponjës. Jashtë unazës-kurorë-ngjyrë ari, rrethon e kufizon katrori më sfond të zi.



Logo i P.B-esë: Dim. : 35 x 35 cm.

Flamuri zyrtar ka proporcionet standarde: 100 x 60cm , më sfond të zi, e në mes të flamurit ka një fushë rrethore të bardhë mbi të cilën pushon shqiponja e zezë bicefale, ajo e Partisë Balliste, më inicialet e logos: “P.B“ mbi kokë, ndërsa shqiponja e flamurit ceremonial pushon mbi fushërrethore të kuqe e proporcionet e flamujve janë të njejtë.



Flamuri zyrtar i P.B-së (100 x 60 cm)



Flamur ceremonial i P.B-së (100x60cm)

Vula e partisë Balliste ka formë rrethore e përmbanë: emrin e Partisë, inicialet e logos, shqiponjen e P.B-së, adresen e selisë dhe numrin e vulës;

Selija është e vendosur në Novosellë, Rrethi administrativ i Pejës, e që me vendim të Drejtoratit Madhor të Partisë Balliste (D.M.P.B), adresa e selisë mund të ndërrohet kurdo dhe kudo, nëse e kërkon interesi i Partisë, sidomos në rast të gjendjes madhore, që Partia mundet të instalohet dhe strukturohet përkohësisht dhe për aq kohë sa është e nevojshme jashtë Rrepublicës së Kosovës.

Neni 2 a.

Konstituimi dhe kohëzgjatëja e P.B-së

Partia Balliste është konstituuar për një kohëzgjatje të pakufizuar.

KREU II-TË.

Struktura e anëtarëve të Partisë dhe Rregulloret statutare të anëtarësimit në Partinë Balliste

Neni 3

Struktura e anëtarëve të P.B-së përbëhet nga

- a) anëtarët fondator,
- b) anëtarët efektiv (militantë) dhe
- c) adhurues apo simpatizantë.

3a) Anëtarët fondator të P.B-së janë nënshkruarit e të tanishmit akt, janë lideri dhe *efektivi i konstituimit të subjektit të celulës bazë*, të Drejtoratit Madhor të Partisë Balliste, jo më pak se tre dhe më të drejtë vote të barabartë brenda gjirit të Partisë.

3b) Anëtarët efektiv (militantë) të P.B-së kanë të drejtë të votohen dhe të votojnë për strukturat vendimarrëse të Partisë.

3c) Anëtarët adhurues të P.B-së janë përkrahës dhe përmbajtës të Partisë pa të drejtë pjesëmarrjeje në strukturat vendimarrëse të Partisë, por e kanë të drejten e pjesëmarrjes në votime të përgjithshme të Partisë (më prezentim të Kartës së anëtarësimit në Partinë Balliste dhe të letërnjoftimit apo pasaportës), po ashtu dhe në manifestime dhe aksione partiake.

Neni 3.1

Përgjegjësia e Anëtarëve të Partisë Balliste

Anëtarët fondator, militant (efektif), adhurues dhe zyrtarët e P.B-esë, nuk janë përgjegjës për borxhet e Partisë Balliste.

Neni 4

Rregulloret statutare t'anëtarësimit në Partinë Balliste

- a) Pranimi,
- b) Dorëheqja,
- c) Përfshirja,
- d) Komunikimi i listës së anëtarëve të Partisë,
- e) Garancioni ndaj anëtarëve të partisë,
- f) Të drejtat e anëtarëve të P.B-së dhe
- g) Bashkëpunimi elektoral me parti e shoqata, por jo koalicion me parti tjera.

4a) Pranimi i anëtarëve në Partinë Balliste (P.B-e)

- Odat Balliste Bashkiake dhe Odat Balliste Lokale janë të vetmet kompetente për pranim të anëtarëve në parti.
- I interesuari për t'u anëtarësuar në P.B-e duhet të ketë plotësuar moshën 18-të vjeçare, të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, ku gjinija dhe feja nuk janë kusht. Pra, pasi që gjinija nuk është kusht për t'u anëtarësuar në Partinë Balliste as për t'u votuar apo të votojë, pra në P.B-e Forumi i gruas nuk egziston;
- Kërkesa për t'u anëtarësuar në P.B-e bëhet pranë Odës së lokalitetit që i përket (të asajë lokale apo bashkijake). Anëtarësimi bëhet individualisht dhe më dëshirë të vet.
- I interesuari duhet t'u përmbahet Statutit dhe Programit të P.B-së, të mbajë kontakt dhe dialog të afert me popullin e vet, përfshirë anëtarët e Partisë.
- Më pranimin e një mandati, duhet t'angazhohet t'e respektojë « Obligimet e Mandatarit » .
- Të participojë aktivisht me prezencën e vetë dhe investim personal në iniciativat e P.B-së dhe në lëvizje të aksioneve të përbashkëta të partisë, poashtu duhet të mbajë integritet ndaj tjerëve;
- Çdo anëtar i partisë, përfshirë Kryetarin e Partisë dhe zyrtarët tjerë të Partisë Balliste të regjistruar politike, duhet të jenë anëtarë të partisë dhe të çertifkohen më Librezë të Partisë; njëherit duhet të paguajnë kuotizacionin e anëtarësimit në Parti, shumë kjo e përcaktuar më nenin 17 në Rregullën Nr. 01/2013 për regjistrimin dhe veprimin e partive politike mbrenda Rrepublikës së Kosovës.

4b) Dorëheqja

Anëtarët e P.B-esë mundën të demisionojnë (të tërhiqen) nga Partia, në çdo kohë, edhe pa plotësim të formularit të veçantë për dorëheqje.

4c) Përjashtimi nga partia

Arësytet që çojnë deri në përjashtim nga Partia janë mosrespektimi dhe moszbatimi i Statutit, rregulloreve dhe programit të P.B-së:

- nëse anëtari i P.B-së bashkëpunon pa autorizim të Drejtorati Madhor i Partisë Balliste më një tjetër parti apo lëvizje politike;
- mospagesa e anëtarësisë,
- nëse anëtari i Partisë i bënë lajka Partisë dhe vepron kokë më vete për interes të vet apo të dikujt tjetër, duke shfrytëzuar emrin e Partisë Balliste, ose
- kur anëtarët e D.M.P.B-së apo të Kuvendit të P.B-së devijonë më qëllim rrugën e Partisë, Kryetari i Partisë merr vendimin përfundimtar për aktivitetin politik të atij individi mbrenda kornizës së Partisë Balliste.
-

4d) Komunikimi i listës së anëtarëve të Partisë

Çdo lokalitet i Partisë Balliste për çdo vjet duhet t'ë transmetojë listën complete të anëtarëve të vet (me identitet egzak), lista duhet përfshirë anëtarët që janë në rregull më kautizacion (pagesë) të anëtarësisë për vitin e parafundit. Lista duhet dorzuar më së largu ditën e fundit të punës të muajit Shkurt në Sekretariat Kombëtar të P.B-esë.

4e) P.B-eja ju garantonë anëtarëve të vet :

- 1) formacion militantëve dhe mandaterëve rreth dhe për Partinë,
- 2) Të drejtë në difyzione interne të informatave të P.B-esë,
- 3) participim i të gjithave dhe të gjithëve, ashtu si më statute të tanishme (pa dallim gjinije as feje),
- 4) transparencë të procesusit të vendimeve,
- 5) rrespektim ndaj vendimeve të marrura nga instancat vendimarrëse të P.B-së,
- 6) lirinë e shprehjes, të drejtën e tendencës dhe debatin kontradiktoar dhe
- 7) rrespekt për jetën private.

4f) Të drejtat e anëtarëve të P.B-së për tu informuar

Anëtarët Partisë Balliste gëzojnë të drejtat e barabarta në kornizën e Partisë:

- kanë të drejtë të participojnë, të mendojnë, të veprojnë, të jenë të informuar në tërësi rreth Partisë,
- t'i kenë dyertë e hapura për të shqyrtuar në dokumentacion që Partia e ka në dispozicion për anëtarët e Partisë.
- Të marrin pjesë në debate të orientimit të P.B-së,
- të informohen rreth propozimeve dhe ndryshimeve në Parti,
- të propozojnë, të propozohen, të këshillojnë dhe të këshillohen nga Partia dhe në Parti,
- të jenë aktivë e të lytojnë, të lobojnë për aç militant të Partisë Balliste.
- Gjithashtu, gëzojnë të drejtën për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e Partisë dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare.

4g) Koalicioni dhe bashkëpunimi elektoral me parti e shoqata

Partia Balliste nuk është adhuruese e koalicioneve partiake dhe as nuk i bashkangjitet asnjë partie politike, por pranonë ardhjen apo shkrirjen e partive të tjera në gjirin e P.B-esë që vendimi merret nga Drejtorati Madhor i P.B-esë në bashkujdi me Drejtoratin e Kuvendit të P.B-esë. P.B-eja është Parti e djathtë me tipare përparimtare të nivelit njerëzorë, të principit atdhetar, ka mentalitet bujar së nuk e ndien veten inferiore.

KREU III

Neni 5

Fonkcionimi i mjeteve të informacionit dhe pasurisë së Partisë Balliste

Të gjitha institucionet e P.B-së : qendrat, postat dhe antenat diferente, mjetet e ndryshme të informacionit, të mirat e tundshme dhe të patundshme në tërësi, donacionet e ndryshme në favor të P.B-së, funksionojnë me rregulloret e P.B-së dhe çdoherë transparente në pajtim me Rregulloren Nr. 01/2013 për regjistrimin dhe veprimin e partive politike në Rrepublikën e Kosovës.

Neni 5.1

Financimi dhe fondet e partisë

Të ardhurat e partisë mundë të kenë burimin brenda apo jashtë shtetit tonë, nga

- veprimtarija botuese dhe informative e Partisë;
- programet e aktivitetet kulturore, artistike, sportive, ... etj. të organizuera, të kontraktuera apo të instoruera nga P.B-eja;
- shoqatat, qëndrat, klubet, të mirat pronësore të tundëshme dhe të patundëshme të ndryshme brenda gjirit të P.B-së;
- donacionet (të tundëshme dhe të patundëshme) nga personat fizik, ... etj. , subvencione publike (eventualisht), individuale e të ndryshme, për të miren e Partisë;
- donacionet qeveritare të akorduera relative me kontrollin e kufizimeve të shpenzimeve elektorale, gjithashtu të financimit dhe komptabilitetit të hapur për partitë politike;
- kontributet nga grupet parlamentare, regjionale, ... etj.;
- kuatizacionet (anëtarësia) nga anëtarët e partisë;
- të ardhurat që vijnë nga manifestacionet, publikacionet si dhe recetet nga publiciteti dhe kongtributet që derdhen nga kompozantet dhe mandateret e partisë.

Neni 5.2 **Shpenzimet e partisë**

- Shpenzimet e kabineteve të partisë (qeraja, mobilëje, ekipement informatik, nxemëje, ndriçim, uji, mirëmbajtëje, ... etj.),
- deplasmant e transport të personelit (mobilitet në përgjithësi),
- remynerime personeleve të funksionimit administrativ të partisë,
- shpenzimet për informacion dhe propaganda,
- investim jo direkt produktif,
- shpenzimet elektorale, ... etj.

Neni 5.3 **Kompta bankiere**

P.B-eja duhet të posedojë sëpaku një xhirollogari bankiere pranë një banke në teritorin e Rrepublicës së Kosovës, e më menaxhim të mjeteve financiare të P.B-së vendosë Drejtorati Madhor i Partisë Balliste (D.M.P.B-ja). Menaxhimi financiar i P.B-së është në administrimin e Servisit financiar që është pjesë e Sekretariatit **Kombëtar të P.B-së**.

Neni 5.4 **Komptat vjetore dhe Raporti financiar i P.B-së**

5.4a) Komptat vjetore dhe gjestioni i fondeve të Partisë determinohen më rregulloren e mbrendëshme të Partisë dhe sipas planit komptabel, e që ekzersisi komptabel shkonë nga 01 Janari e deri më 31 Dhjetor të çdo viti civil.

Dokumentat dhe pjeset komptable konzervohen 5-së vite.

5.4b) Shërbimi i komptabilitetit është më seli në Komision Financiar që ndodhet në gjiun e Sekretariatit Kombëtar të Partisë, publikon çdo vit një raport justifikatif të receteve (gjendejeve) financiare dhe ekonomike të partisë. - Ky raport ka të bëjë më gjendejen e financimeve dhe shpenzimëve në tërësi të partisë.

Neni 5.5 **Instancat financiare të P.B-së**

Instancat financiare (komptabiliteti dhe inspektoriatit financiar) emërohen nga Drejtorati Madhor i Partisë, kanë autoritet dhe kompetencë për kontrollë të përgjithëshme të komptabilitetit në gjirin e P.B-së, ushtrojnë kontrollin e mbrendëshem financiar dhe punojnë në mënyrë të

pamvarur e jep llogari vetem para Drejtoratit Madhor të P.B-esë në prezencë të Drejtoratit të Kuvendit të Partisë.

Për vuerje në dritë të raportit financiar të P.B-së dhe të Servisit komptabel, Servisi financiar në rast nevojë përcakton një apo më shumë revizor të kontrollit financiar.

Shërbimi i komptabilitetit dhe Servisi financiar janë një kompakt me seli në Sekretariat Kombëtar të P.B-së.

KREU IV

- **Veprimi i partisë dhe hyrja në fuqi e Statutit të P.B-së**
- **Ndryshimet në statut dhe program të partisë ...**
- **Fundi i aktivitetit të Partisë**

Neni 6

Veprimi i Partisë dhe hyrja në fuqi e Statutit të P.B-së;

Statuti i Partisë Balliste dhe partia vet, për aç Parti politike, hynë në fuqi me nënshkrim të tanishmit Akt nga konstituesit e të tanishmes Parti, ndërsa me regjistrim e publikim zyrtar të këti Statuti, partia gëzon vleren e personalitetit juridik, e për gjykatë zgjedhë Gjykatën Themelore në Pejë.

Neni 7

Ndryshimet në Statut ose Program politik të Partisë dhe Njoftimi për ndryshimet

Partia Balliste mbanë të drejten e ndryshimeve në statut të partisë, kurdo që strategjia e partisë e kërkon.

Statuti dhe Programi i P.B-së janë transparent, të diskutueshem dhe të modifikueshem.

Ndryshimet në statut veprohen nga Kuvendi i partisë në koordinim paraprakisht me “Zyren” duke marrë parasysh kërkesat nga neni 5(c) dhe (d) dhe Nenin 10.2 të Rregullores Nr.01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e partive politike në Republikën e Kosovës.

Partia Balliste përmbanë Nenin 10-të dhe 11-të të cekur më Rregullen Nr. 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e partive politike në Republikën e Kosovës.

Neni 7.1

Të dhënat e ndryshuara vjetore

Partia Balliste e regjistruar politike e ka për obligim sipas agjendarit të Kryetarit të partisë dhe sipas **nenit 11-të të Rregullores Nr. 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e partive politike** në Republikën e Kosovës, t'i dorzon Zyres të dhënat e ndryshuara vjetore: shtojca 6, më së largu deri më 31 Janar të çdo viti.

Neni 8

Fundi i aktivitetit të Partisë

Më vendim të Drejtoratit Madhor të Partisë, por më aprovim vendimi nga Kryetari i Partisë, veprimtaria dhe aktiviteti i P.B-së (Partisë Balliste), mundet të ndërpritet, në çdo kohë dhe vend, definitivisht apo përkohësisht, ose të shuhet, të shkrihet, apo të asociohet me një parti tjetër, e që vendimi i marrur hip në fuqi menjëherë me nënshkrimin e Kryetarit të Partisë.

Në mungesë të Kryetarit të P.B-esë, Zëvendës-Kryetari i Partisë nënshkruen aprovimin.

Vendimi i „Fundit të aktivitetit të Partisë“ duhet dorzuar për informim dhe publikim në institucionin përkatës „Zyra“ pranë KQZ-së.

Neni 8.1

Në rast të forcës madhore ndaj P.B-së, rast i konstatuar nga Drejtorati Madhor i Partisë Balliste, Kryetari **në bashkëpunim** më Drejtoratin Madhor dhe Drejtoratin e Kuvendit të Partisë merrë vendim të prerë për:

- shuerje të P.B-së,
- ndërprerëje të përkohëshme t'aktivitetit, apo
- t'instalojë dhe strukturoj celulen strategjike të P.B-së, për një kohë të pa kufizuar jasht Republikës së Kosovës.

Neni 8.2

Në rast të ndërprerjes të aktivitetit, disolucionit (shumjës), bashkimit, shkrimjes së Partisë Balliste, nëse P.B-ja e ka mundësinë, i kryen pagesat e fakturave, borxheve, remyneracioneve, ... etj., ndërsa mbetëja i dhurohet ndoj organizate, shoqate apo lëvizje rrevolucionare pa qëllim fitimi, të vendit apo të hueja.

KREU V

Strukturat e Partisë Balliste në rangun kombëtar

Neni 9

P.B-ja në strukturën e vet të rangut kombëtar përbëhet nga dy bërthama:

- **Drejtorati Madhor i Partisë dhe**
- **Kuvendi i Partisë.**

Neni 10

Drejtorati Madhor i Partisë Balliste është bërthama amzë e strategjisë politike në gjirin e Partisë: planifikon strategjinë politike të tërë partisë, kontrollon dhe shqyrton për aprovim të çdo paravendimi, propozimi apo dhe vendimi të Kuvendit të Partisë, e në raste kontestuese në gjirin e Kuvendit, është Drejtorati Madhor i Partisë që ndërhyjnë për rezolim të situatës.

Neni 10.1

Drejtorati Madhor i Partisë Balliste merrë mbi veti tërë drejtimin ditor të partisë, së është organ kompetent që vendosë, përgadit, drejton dhe përcjellë veprimin e mandaterve të vet në gjirin e Partisë.

Neni 10.2

Struktura e Drejtoratit Madhor të Partisë Balliste

Bërthama e D.M.P.E-së është e përbërë nga

- 1) Kryetari,
- 2) Zëvendës kryetari 1-rë
- 3) Zëvendës kryetari i 2-të
- 4) Sekretari politik,
- 5) Sekretar administrativ,
- 6) Sekretari organizativ dhe
- 7) Koordinator

Neni 10.3

Mandati i anëtarëve të D.M.P.B-esë

Anëtarët e Drejtoratit Madhor të Partisë Balliste votohen në mënyrë transparente e demokratike, nga Kuvendi i Partisë me mandat 4 (katër) vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Neni 10.4

Funkcionimi i Drejtoratit Madhor të Partisë

Drejtorati Madhor i Partisë Balliste (D.M.P.B) funksionon sipas Agjendarit të vet, duke marrë për bazë Agjendarin e Kryetarit të Partisë.

Neni 11

Kryetari i partisë

- a) Kryetari i Partisë Balliste është Lider dhe orator i parë i Partisë, është organi më i lartë ekzekutiv i partisë, i vendosur për mandat 4-tër vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.
- b) Procedura për zgjedhje të Kryetarit të Partisë Balliste përcaktohet dhe realizohet nga Drejtorati Madhor i Partisë në bashkëpunim me Drejtoratin e Kuvendit të Partisë.
- c) Më regjistrim të Partisë Balliste, zgjedhja për herë të parë e Kryetarit të Partisë Balliste, që është organi më i lartë ekzekutiv i Partisë, bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e regjistrimit të Partisë, pastaj çdo 48 (dyzet e tetë) muaj.
- d) Pushteti dhe përgjegjësia e Kryetarit të P.B-së ka të bëjë në çdo fushë dhe nivel të partisë, e në mungesë të Kryetarit të partisë dhe në raste të forcave majore, është Zëvendës-Kryetari që udhëheqë me Parti.
- e) Kryetari i P.B-esë punon dhe vepron sipas agjendarit të vet, e njëherit mbanë përgjegjësi për gazetën e P.B-së.
- f) **Imuniteti i Kryetarit të P.B-esë bjen:** nëse vet Kryetari shpreh dëshirën për largim nga funksioni i Kryetarit të partisë, nëse Kryetari i shkel me qëllim normat njerzore dhe kombëtare, apo nëse konstatohet mosaftësija shëndetësore e tij për dirigjim me partinë.
- g) Kryetari i partisë është i vetëmi që ka pushtet të autorizon një apo më shumë të autorizuar për marrëveshjeje në emër të partisë.

KREU VI

Kuvendi i Partisë Balliste

Neni 12

Struktura më e gjërë vendim-marrëse e **Partisë Balliste** është Kuvendi, që përmbanë në veti dy struktura:

- a) **Drejtoratin e Kuvendit dhe**
- b) **Anëtarët e Kuvendit**

Neni 12 a.

Drejtorati i Kuvendit të P.B-esë

Struktura e Drejtoratit të Kuvendit të P.B-esë përbëhet nga

- 1) Drejtori i Kuvendit,
- 2) Zëvendës-Drejtori
- 3) 3 (tre) Këshilltarë dhe
- 4) Referenti

janë të emëruar për mandate 4-tër vjeçar, e më të drejtë rizgjedhje.

Neni 12 b.

Anëtarët e Kuvendit të Partisë Balliste

Anëtarët e kuvendi të P.B-esë janë:

- **Sekretarë politik : nga 1 (një) për Qark administrativ dhe**
- **Kuvendartë (delegatet) nga 1 (një) për Komunë.**

janë orator – avokat të popullit të zgjedhur me vota të lira – demokratike dhe transparente nga gjiri i strukturave të P.B-esë të distriktit që i përkasin, të gjithë me të drejtë vote të barabart në gjirin e Kuvendit të Partisë, të zgjedhur për mandat 4-tër vjeçar e më të drejtë rizgjedhje.

- Kuvendi i 1-rë (parë) i Partisë Balliste mbahet brenda 6-të (gjashtë) muajve nga data e regjistrimit të partisë dhe pastaj çdo 4-tër (katër) vite.
- Kuvendi i Partisë Belliste zgjedhë Kryetarin e partisë që është organi më i lartë ekzekutiv i partisë.
- Anëtarët e Kuvendit kanë votë të barabartë në vendimet e marrurabrenda Kuvendit të P.B-esë, duke përfshirë votimin për zgjedhëje të Kryetarit të Partisë dhe të organit mmë të lartë egzekutiv të partisë.
- Për post të delegatit të Kuvendit të P.B-esë mund të kandidoj çdo militant i Partisë Balliste që nuk është i sanksionuar nga instanca diciplinore e Partisë dhe që janë në rregull më kuotizacion. Kandidaturen duhet parashtruar pranë Odës së lokalitetit që i përketë (Bashkijake apo Lokale).

Neni 12 c.

Obligimet e Partisë Balliste ndaj „Zyres“ për mbajtjen e Kuvendit

P.B-eja e ka për obligim që në afat prej 5 ditë pune nga dita e majtjes së Kuvendit të saj, të njoftojë „Zyren“ duke paraqitur kopjet e procesverbalit të Kuvendit të mbajtur e i cili duhet të vërtetohet nga Kryetari i Partisë.

Partia Balliste e regjistruar politike e ka për obligim ta ftojë „Zyren“ për ta vëzhguar Kuvendin, gjithashtu duhet të njofton „Zyren“ për të vëzhguar kuvendin e degës së saj përkatëse.

Neni 12 d.

Qëllimi i Kuvendit të P.B-esë

Kuvendi i P.B-së e ka për qëllim dhënjen e mundësisë më të mirë për themelimin të mentalitetit t'atëdhetarizmit kombëtar dhe parashtrimin pasqyruar e transparent të strategjisë politike-globale të Partisë Balliste më ekstancion nacional-rrevolucionar, e që nuk ka rëndësi a ndodhet P.B-eja në pozitë apo në opozitë, por që të përgaditë dhe shprehë teorikisht dhe në praktikë mentalitetin e tij në interes të atëdheut dhe popullit.

Kuvendi duhet të jetë i pranueshem nga populli-adhures i ballizmit dhe të ket aspektin e ballafaçimit për bashkëmendim e ujdë në interesin e përgjithëshem kombëtar.

Në Kuvend zgjedhen anëtar të postave të ndryshme për funksione në gjirin e Partisë Balliste.

Neni 12e .

Kuvende të jashtëzakonshme

Kryetari i Partisë Balliste, më mbështetje të shumicës së anëtarëve të D.M.P.B-esë dhe Drejtoratit të Kuvendit mundet të thërret seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të P.B-esë, për aq herë sa e kërkon nevoja e Partisë.

Neni 12 f.

Pranimi i vendimeve të marrura në Kuvend

Puna e Kuvendit dhe vendimet e marrura në Kuvend pranohen të ligjshme nëse 50% + 1 të delegatëve janë prezent në Kuvend.

Vendimet e Kuvendit, në të shumtën e rasteve janë të pranueshme nga Kryetari i P.B-esë dhe Drejtorati Madhor i P.B-esë, por nëse vërehet jo korrektësia apo qëllim-sabotimi nga ndonjëri i anëtarëve të D.M.P.B-së, Drejtoratit të Kuvendit të P.B-esë apo të delegatëve që kanë të çojnë kundraj të mirës së P.B-esë, më urdher të Kryetarit të Partisë iniciatori i ekcesit largohet nga Kuvendi dhe përjashtohet nga Partia.

Neni 12 g.

Realizimi i normave të Kuvendit të P.B-esë

P.B-ja e regjistruar politike e ka obligim ta ftojë „Zyren“ për ta vëzhguar Kuvendin, dhe t'i dorzojë „Zyrës“ një kopje të proces verbalit të mbajtëjes së Kuvendit, në afat prej 5-së ditë pune nga dita e mbajtëjes së Kuvendit të saj, të vërtetuar nga Kryetari i Partisë.

Neni 12 h.

Procedurat për caktimin e kandidatëve të Partisë Balliste në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe të Kuvendeve komunale

Procedurat për caktimin e kandidatëve të partisë në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe të Kuvendeve komunale bëhet nëpërmjet përfaqësuesve të përfaqësive të rangjeve që i përkasin, pra zgjidhen në seancat gjenerale nga organet partiake të rangjeve ku veprojnë, propozohen dhe votohen në mënyrë transparente dhe demokratike.

Udhëzimet për realizimin e procedurës për caktimin e kandidatëve të Partisë në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe të Kuvendeve komunale strukturohen nga Drejtorati Madhor i P.B-esë në bashkëpunim me Drejtoratin e Kuvendit të P.B-esë.

KREU VII

Neni 13

Strukturat e P.B-esë në rangjet e Qarqeve Administrative

Strukturat e P.B-esë në rangjet e Qarqeve Administrative zgjidhen në Asamblet gjenerale të rangjeve që u përkasin, më votim transparent e demokratik, me mandat 4-tër vjeçar e më të drejtë rizgjedhje.

Zgjedhjet mbahen brenda muajit qërshor, e modalitetet e votimit përcaktohen nga votra për votime e P.B-esë.

Kusht kandidatimi për t'u votuar për njenën nga Odat e rangjeve të Qarqeve Administrative (t'atij lokal, bashkijak apo krahinor) është që kandidatet duhet të jenë militant të Partisë, me princip dhe moralitet ballist dhe në rregull me kuotizacione anëtarsh, e për t'u zgjedhë duhet t'e ketë sëpaku një votë më tepër së rivali.

Neni 13 a.

Partia Balliste në rangjet e Qarqeve Administrative ka tri struktura të nivelit organizativ politik :

- **Odat e Qarqeve Administrative ,**
- **Odat Bashkijake dhe**
- **Odat Lokale**

Neni 13 b.

Oda e Qarkut Administrativ e P.B-së është organi më i lartë i P.B-së në rangun e një

Qarku administrativ, e udhëhequr nga

- **Drejtori,**
- **Sekretari Politik,**
- **2 këshilltarë dhe**
- **arkatari,**

të gjithë të zgjedhur në Asamblenë Gjenerale të Odës së qarkut administrativ dhe të nxjerrur nga përfaqësuesit e lokaliteteve të Qarkut administrativ që i përkasin, duke u bazuar në rregullore të votres për votime të P.B-esë, të zgjedhur në mënyrë transparente e demokratike për mandat 4-tër vjeçar e më të dejtë rizgjedhje.

Odat e Qarqeve Administrative të P.B-së nuk e kanë kompetencën për pranimit t'anëtarëve në Parti, së kompetenca për pranimit t'anëtarëve në Parti ju takonë Odave Bashkijake dhe Odave Lokale të P.B-esë.

Neni 13 c.

Drejtoret e Odave të Qarqeve Administrative të P.B-së

Drejtoret e Odave të Qarqeve Administrative janë orator të parë të Partisë mbrenda teritorit të qarkut administrativ që i përkasin, e që imunitetin mund t'ju terhjek vetem Drejtorati Madhor i P.B-esë.

Neni 13 d.

Nër patronatin partijk të Odave të Qarqeve Administrative të Partisë Balliste janë:

- ***Odat Bashkijake dhe***
- ***Odat Lokale të P.B-esë***

Neni 13 e.

Oda Bashkijake e P.B-esë udhëheqët nga

- **Drejtori,**
- **Sekretari Politik,**
- **2 këshilltarë dhe**
- **arkatari**

të zgjedhur në Asamblenë Gjenerale të Odës Bashkijake, të nxjerrur nga celulat përfaqësuese të lokaliteteve që ju përkasin, duke u bazuar në rregullore të Votres për votime të P.B-esë, të zgjedhur për mandat 4-tër vjeçar e më të drejtë rizgjedhje.

Neni 13 f.

Oda Lokale e P.B-esë udhëheçët nga

- Sekretari politik,
- 2 këshilltarë dhe
- Arkatari,

të zgjedhur në Asamblenë gjenerale të Odes Lokale, anëtarë të propozuar nga militantet e partisë të lokalitetit që i përkasin, sipas rregulloreve të Votres për votime të P.B-esë, të zgjedhur për mandat 4-tër vjeçar e më të drejtë rizgjedhje

KREU VIII

Neni 14

Agjendari dhe Votimet e Partisë Balliste

- 1) **Agjendari i P.B-esë** përgaditet nga Kryetari i Partisë Balliste.
- 2) **Votimet** e çdo rangu të Partisë Balliste janë të sistemit: „**një anëtar, një votë**“, e për t’ë marrë formën e preht duhet që dekreti, pika apo personi që votohet të përmbahet sëpaku me një votë më tepër së votat „KUNDRAJ“ apo më tepër së votat e rivalit.
- 3) Votimet realizohen sipas rregulloreve të vura në pikë nga Drejtorati Madhor, Drejtorati i Kuvendit dhe Votra për votime të P.B-esë, por ndryshimet mund të kenë vend aç herë sa të ndihet e nevojëshme në të mirë të Partisë.
- 4) Votat me prokuracion dhe ato më korrespondencë janë të pranueshme.

KREU IX

Neni 15

Sekretarjati Kombëtar & Votra për votime të P.B-esë

Sekretariati Kombëtar dhe Votra për Votime janë zyre e përbashket administrativo-ligjore të P.B-esë, punojnë krahaz me Drejtoratin Madhor dhe Drejtoratin e Kuvendit të Partisë, mbajnë strikt sekretet e Partisë : kanë të bëjnë me administraten, arrëshivat, shqyrtimit të kandidaturave (ankesave, masave dicitlinore, organizimin e zbatimin e çdo norme rreth e për votime, tubimeve të Partisë, konferenca, mitingje si dhe financë e demarshe adminostrativo-ligjore të Partisë).

Pjesë përbërëse e Sekretarjatit Kombëtar dhe Votrës për Votime të P.B-esë janë :

- Servisi administratif,
- Kontrolli i brendshem financiar dhe
- Komisioni dicitlinor.

Neni 15 a.

Servisi administrativ është pjesë përberëse e Sekretariatit kombëtar që mbanë në kontrollë tër shërbimet administrative të Partisë Balliste.

Neni 15 b.

Kontrolli i brendshem financiar

P.B-eja ju mundësonë anëtarëve të vet, çka është edhe e drejtë e anëtarëve militant të P.B-esë, të furnizohen me dokumentacion provash të gjendëjës financiare të Partisë Balliste, konkretisht mbi hyrjet dhe daljet financiare, numër të gjyrolligarisë bankiere, ... etj. informacione.

Kontrolli, azhurimi financiar dhe kontabiliteti në përgjithësi i P.B-esë është nën kujdesin e përfaqësuesit financiar (ekspertit kontabel dhe arkatarit) të P.B-esë.

Bilani financiar dhe buxheti vjetor i Partisë në nivel vendor miratohen mbas shqyrtimit në Kuvend të Përgjithshem të Partisë Balliste.

Veprimtaria financiare dhe ajo ekonomike të P.B-së parashtrihen në shqyrtim, sëpaku njëherë në vit, para Drejtoratit Madhor dhe Drejtoratit të Kuvendit të Partisë Balliste.

Neni 15 c.

Komisioni Dicitlinor i P.B-së është pjesë përbërëse e Sekretarjatit Kombëtar të P.B-esë, e që pjestar i Komisionit Dicitlinor të Partisë është edhe vet Kryetari i Partisë apo i mandatuari i tij.

Komisioni dicitlinor mirret më shqyrtim të çdo violacioni të vepruar nga anëtarët e partisë ndaj dispozicioneve të këtyre statuteve partijake.

Për violacionet e dispozicioneve të tanishëmit STATUT, violacione që çojnë në procedurë disiplinore të paraparë më rregulloren e mbrendëshme të Partisë, masat mirren nga interpretuesi i statuteve të P.B-esë, e ky është «Komisioni Diciplinor i P.B-esë».

Neni 16

Mospërgjegjësia e P.B-esë ...

Drejtorati Madhor i P.B-së si dhe mbarë Partia, n'asnjë mënyrë, n'asnjë rast dhe n'asnjë vend dhe kohë nuk e ndinë veten fajtores dhe as përgjegjëse për agjitime e veprime të ndryshme pa lejen e Drejtoratit Madhor të Partisë.

Çdo demarsh apo akcion nga Strukturat dhe anëtarët e P.B-esë, në emër të Partisë, duhet të veprohet me urdhër dhe autorizim zyrtar nga Drejtorati Madhor i Partisë Balliste.

Neni 17

Sanksionet

Për mosrrespektimin e normave dhe rregulloreve, në kuptimin e përbashkët të termit të statuteve të P.B-esë, anëtari i partisë sanksionohet sipas gravitetit të veprimit, më :

- vërejtje,
- kritikë,
- suspension mandati apo të funksionit,
- revokim (heçje) mandati apo të funksionit,
- revokim (heçje) i të gjith mandateve të funksioneve në Parti,
- ndalim për prezentim të kandidaturës për mandat apo funksion intern në Parti,
- ndalesë të figurojë në ndojë listë elektorale të Partisë apo të investueme nga Partia për ndoj mandat elektif,
- suspension të kualitetit të nëtarit të Partisë dhe
- largim nga Partia.

Neni 18

Ankesat

Kundraç çdo vendimit të marrur nga Strukturat e P.B-esë, pala e paknaçur mund të parashtrojë ankesen pranë Sekretariatit Kombëtar të Partisë më specifikim: „Servisi për ankesa dhe reklamime“.

Ankesat duhet dorzuar mbrenda afatit 5 (pesë) ditë pune nga dita e marrëjes së aktit apo vendimit.

Neni 19

Konferencat e P.B-esë.

- a) Konferencat e P.B-esë janë nacionale, krahinore, bashkijake dhe lokale, mbahen aç herë sa t'e kërkon stratexhija e Partisë: janë tubime me dyer të mbyllura apo tubime publike.

- b) Konferencat me dyer të mbyllura, të çdo rangu dhe niveli të Partisë Balliste, të mbajtura mbrenda lokaleve dhe tereneve private të Partisë, të marrura me çira apo të dhënuna në shërbim, janë tubime me rregullore të mbrendëshme të Partisë që nuk imponohet leje nga rendi public për mbajtëje të tubimit e që të drejtë participimi kanë militantet, adhuruesit dhe dhe musafiret e ftuar zyrtarisht apo miqësisht;
- c) Mbajtëja e Konferencave publike apo mitinxheve dhe demonstratave në teritore publike (të cilat nuk i takojnë për aq pronës private), manifestohen me leje manifestimi të lëshuara nga Autoriteti i rendit publik të lokalitetit ku do të mamifestohet;
- d) Konferencat dhe tubimet e ndryshme të P.B-esë, organizohen, urdhërohen dhe dirigjohen nga instancat e strukturave dirigjuese të P.B-së, por më pëlçim të dhënur më shkrim nga Drejtorati Madhor i Partisë dhe të nënshkruera nga Kryetari i Partisë, e në rast mungese të Kryetarit, Zëvendës-Kryetari apo i autorizuari i Kryetarit firmosë më citim: „Për Kryetarin e Partisë“.
- e) Për çdo lloj tubimi partijak duhet mbajtë **Proçes-verbal apo Notë** më norma zyrtare, të hartuera në Librin e Proçes-verbalit dhe të nënshkruhet nga drejtuesi i konferencës dhe hartuesi i Proçes-verbalit apo Notës.

KREU X

Neni 20

Dispozitat tranzitore

Me aprovim të akteve të përmbledhura në këte statut, e konstatuar që Partia Balliste është e regjistruar ligjerishtë, e nënshkruesit e të tanishmit akt dhe delegatet prezent në Kuvend të sotëshëm vendosen të aprovojnë konkluzionet e të tanishëmmit akt dhe zgjedhen doren e strategjisë dirigjuese të P.B-esë me titullin emërues: « Drejtorati Madhor i Partisë Balliste» në abrezhim : “D.M.P.B”.

Zgjedhen për Kryetar të Partisë Balliste: Zotëri Pajazit Podrimçaku.

Në vend dhe datë: cekur në fillim të këti Statuti.

Leximi i bërë pjesëmarrësve, të cilet pranojnë këte mandat për një afat 4-tër vjeçar, duke qenë në gjendje të ushtrojnë dëtyren dhe aktivitetin politik mbrenda Partisë Balliste në titull gratis.

Pasi që u lexua, të zgjedhurit kanë firmosur modifikimin e Statutit dhe Programit të P.B-esë.

Është Akt..

Kryetari: Z. Pajazit PODRIMÇAKU